Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike

# Projektligjit "Për krijimin e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore"

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Postuar më: 07.08.2019

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka iniciuar projektligjin "Për krijimin e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore" (ASH). Ky projektligj ka si qëllim garantimin e sigurisë dhe ndërveprimit hekurudhor, nëpërmjet hapjes së tregut hekurudhor dhe nxitjes së zhvillimeve teknologjike për një transport hekurudhor të sigurisë së lartë. Fusha e veprimtarisë së ASH është garantimi i sigurisë dhe ndërveprimit hekurudhor, në zbatim të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016.

Ligji Nr. 142/2016, "Kodi hekurudhor i Republikës së Shqipërisë" përcakton në Nenin 69 të tij se "Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore është organi përgjegjës për sigurimin ruajtjen dhe përmirësimin e nivelit të sigurisë hekurudhore".

Gjithashtu, projektligji për ASH përcakton rregullat për përcaktimin e kushteve organizative, funksionale, hierarkike dhe vendimmarrëse të autoritetit hekurudhor të pavarur, përfaqësimin e tij, procedurën për përzgjedhjen e Këshillit drejtues, drejtorit dhe personelit, si dhe përgjegjësitë e tyre.

Përsa më sipër, ftohen grupet e interesit të dërgojnë komentet/rekomandimet brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik.

**Dokumenta:**

- Projektligji
- Relacioni
- Raporti i Vleresimit te Ndikimit

## Diskutimet